

Projekte rrjedhëse të financuara nga Banka për Zhvillim pranë Këshillit të Europës

janar 2022

Emri i projektit	Qëllimi i projektit	Vlera e huasë (milionë euro)	Viti i fillimit të projektit
Projekt për rikonstruim të institucioneve ndëshkuese korrigjuese	Qëllimi i këtij Projekti është që të zhvillohet dhe përmirësohet infrastruktura në institucionet ndëshkuese korrektuese, duke përmirësuar kushtet fizike në burgje si për të burgosurit ashtu edhe për të punësuarit, duke siguruar kapacitet më të madh të sistemit ndëshkues korrektues dhe edukues korrektues dhe duke përmirësuar respektimin e të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve ndëshkuese korrektuese në përputhje me standardet europiane dhe rregullat e burgjeve.	46	2010
Projekt për ndërtimin e sallave të fizkulturës në shkollat fillore dhe rehabilitimi i shkollave fillore dhe të mesme	Projekti synon avancimin e arsimit fizik, si dhe përmirësimin e kushteve të përgjithshme të procesit arsimor të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme. Ky projekt përbëhet nga dy komponentë: 1) ndërtimi dhe furnizimi me pajisje të 70 sallave të fizkulturës në shkollat fillore sa i përket përmirësimit të përgatitjes fizike dhe shëndetit të nxënësve, si dhe aftësisë së tyre për plotësimet e qëllimeve dhe detyrimeve arsimore; dhe 2) rinovimi afërsisht i 240 shkollave fillore dhe të mesme sa i përket sigurimit të mjedisit përkatës për veprimtarinë arsimore.	30	2011
Projekt për ndërtimin dhe modernizimin e Spitalit klinik rajonal në Shtip	Me këtë projekt parashihet ndërtimi i Spitalit klinik rajonal në Shtip me qëllim që të përmirësohet cilësia, shpejtësia dhe vazhdimësia sa i përket sigurimit të shërbimeve shëndetësore në rajonin lindor shëndetësor.	26,9	2015